



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 3, Datë 05.05.2015

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR PROJEKTIN “NDËRTIMI I
HIDROCENTRALIT “PEROLLAJ”, NË PELLGUN UJËMBLEDHËS TË PËRROIT TË
BEXHMILLËS, KOMUNA GOLAJ, QARKU KUKËS

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, Vendimit nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për projektin “Ndërtimi i Hidrocentralit “Perollaj”, në pellgun ujëmbledhës të përroit të Bexhmillës, Komuna Golaj, Qarku Kukës, me subjekt kërkues shoqërinë konçensionare “Fatlum” sh.p.k.
2. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
 - a. Dokumenti i Rregullores së Lejes së Ndërtimit;
 - b. Harta e Planvendosjes së Strukturës së Hidrocentralit “Perollaj”.
3. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për lëshimin e Formularit të Lejes së Ndërtimit.
4. Formulari i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njesisë së Qeverisjes Vendore.
5. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Komuna Golaj për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE EKKT

EGLANTINA GJERMI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



Z. DAMIAN GJIKNURI

MINISTËR I ENERGISË DHE INDUSTRIË



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA

Adelina Greca



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT